

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ ROHANA” SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më datë 02.09.2025, ne te nenshkruarit:

1. **Odesa Hysa**, i datëlindjes 23.12.1994, lindur dhe banuese ne Lushnje, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi J46223098U

themelojme një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin:

“ ROHANA” SHPK.

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Neni 2: Selia

Selia e shoqërisë do të jetë:

Rruga e Plazhit, Nr. Pasurie 69/1, Zona Kadastrale 1791, Golem, Kavaje, Tirane

Shoqeria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

Aktivitet në fushën e turizmit, bar, restorant, hapja dhe manaxhimi i hoteleve, e godinave akomoduese, beach bar dhe ambjenteve në të cilat ushtrohet aktivitet hotelier me plan shërbimi të personalizuar dhe plan shërbimi "çdo gje e përfshirë"(all inclusive), shezllone, stacione plazhi, lundrime turistike, sporte ujore, piste ne det me lokacion, bar, restorant.

Investime në fushën e hotelerisë dhe turizmit, hapjen e bareve dhe restoranteve brenda këtyre strukturave, hapjen, administrimin dhe/ose menaxhimin e lojrave të fatit dhe kazinove brenda hoteleve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kryerje e shërbimeve të agjencive dhe guidave për veprimtari turistike brenda dhe jashtë vendit. Organizimin e aktiviteteve me natyrë sportive e argëtuese. Import – Eksport të mallrave e artikujve të ndryshëm industrialë dhe ushqimore, produkteve të estetikës dhe dermoestetikës, të pajisjeve dhe mjeteve të kazinove, aksesore hotelerie etj.

Shërbim shpërndarje (Delivery) për bar dhe restorant. Hapja dhe menaxhimi i sallave të konferencave në kuadër të aktivitetit hotelier. Hapja, administrimi dhe / ose menaxhimi i funksionimit të qendrave të rekreacionit, me ose pa profil të dermo-estetikës, trajtimit të lëkurës dhe trupit , për masazhe, spa, mirëmbajtje trupore, fitness, dhe pishina.

Aktivitet në fushën e qiradhënies së zyrave, ambjenteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme që i përkasin hotelit. Menaxhim dhe administrim i pasurive të paluajtshme, kryesisht me veprimtari në Hoteleri – Turizëm..

Dhënie me qira të automjeteve të ndryshme.

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 100.000 lekë, i ndarë në 1 kuote. Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Odesa Hysa është zotërues i 1 kuote, me vlerë 100.000 lekë, me 100 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë.

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jete **Odesa Hysa**, i datëlindjes 23.12.1994, lindur Lushnje, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi J46223098U **për një periudhë 5 - vjeçare** me të drejtë riemërimi.

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

Odesa Hysa

